

V E N D I M
Nr.203, datë 3.5.1995

PËR PRIVATIZIMIN E NDËRMARRJEVE TË VOGLA DHE TË MESME

Me propozimin e Agjencisë Kombëtare të Privatizimit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Në këtë vendim, ndërmarrje konsiderohen çdo njësi prodhimi, shërbimi, pjesë të tyre, mjete lundrimi, duke përfshirë edhe mjetet e xhiros së tyre.

Me AKP kuptohet Agjencia Kombëtare e Privatizimit.

Me KPPP kuptohet Komisioni Përgatitor i Procesit të Privatizimit në Ministrinë e Financave.

2. Privatizimi i ndërmarrjeve të vogla e të mesme do të bëhet nëpërmjet ankandit.

Privatizimi bëhet pa ankand vetëm për rastet:

a) Për ish-pronarët e truallit në zbatim të së drejtës së parablerjes sipas ligjit “Për kthimin dhe kompensimin e pronave të ish-pronarëve”.

b) Automjetet, makineritë, paisjet, mjetet e punës për të cilat do të jetë vendosur të shiten të shkëputura nga ndërmarrjet. Ky fakt duhet të dokumentohet mbi bazën e dokumentacionit ekzistues në ndërmarrje. Në rast se punonjësit që i kanë pasur në përdorim nuk bëjnë kërkesë për blerjen e tyre, atëherë ato kalojnë në ankand.

3. Nuk lejohet të bëhet kalimi kapital i ndërmarrjes që është publikuar për privatizim.

4. Procedura e publikimit fillon pasi të jenë dorëzuar në AKP ose në degën e AKP dokumentet e vlerësimit të ndërmarrjes. Dega e AKP e pranon dosjen e ndërmarrjes, në qoftë se ka dokument të rregullt se është kaluar në nënkomisionin përgatitor të privatizimit pranë pushtetit lokal për ndërmarrjet lokale dhe nëpërmjet komisionit përgatitor të privatizimit në Ministrinë e Financave për ndërmarrjet nacionale. Në të kundërtën kërkohet plotësimi i dokumentacionit.

Kur ndërmarrja funksionon në veprimtari të privatizuar, qiramarrësit i kthehet vetëm vlefë e investimeve të domosdoshme që ia kanë rritur vlefën ndërmarrjes. Ky fakt duhet të jetë pjesë e kontratës së qirasë dhe e dokumenteve të ndërmarrjes për privatizim. Investimet e domosdoshme i shtohen vlefës së objektit, duke u indeksuar me çmimet në datën e përgatitjes për privatizim dhe duke ulur amortizimin nga komisioni i vlerësimit në ndërmarrjet.

Shteti nuk merr përsipër kthimin e vlefës së investimeve të nevojshme ose të zakonshme, të cilat qiramarrësi i kryen për interesin e tij.

Kur ndërmarrja ka nënshkruar një kontratë bashkëpunimi a qiraje me një palë të tretë në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi, kontratat janë të detyrueshme për t’u pranuar nga pronari i ri. Ky fakt duhet të jetë pjesë e dokumenteve të ndërmarrjes që dorëzohen në degën e AKP ose AKP nga nënkomisionet përkatëse dhe KPPP në Ministrinë e Financave.

Dega e AKP, me të pranuar dokumentet e vlerësimit të ndërmarrjes, fillon publikimin për privatizim. Periudha e publikimit dhe e pranimi të kërkesave nuk duhet të zgjatë më tepër se 20 ditë nga njoftimi i parë.

a) Vendoset një njoftim në dy nga gazetatat me qarkullim kombëtar të paktën 4 herë në dy javët e para.

b) Vendoset një njoftim në një gazetë të rrethit ku ndodhet objekti ose ndërmarrja të paktën 2 herë në dy javët e para dhe bëhet njoftim me afishe për periudhën që mbetet, por jo më pak se në 4 vende.

Kur nuk ka mundësi botimi në gazetën lokale, njoftimi bëhet me afishe jo më pak se në 6 vende. Afishet detyrimisht vendosen në vendndodhjen e degës së AKP, në qendrën e banuar ku ndodhet ndërmarrja, si dhe në vetë ndërmarrjen që privatizohet.

Këto njoftime duhet të specifikojnë informacionin e mëposhtëm:

- Emrat dhe vendet e njësive që privatizohen.

- Vlefë fillestare e ankandit, ku përfshihet vlefë e ndërmarrjes, investimet e bëra nga qiramarrësi etj.

- Sipërfaqja e ndërmarrjes.

5. Kryetari u degës së AKP përpilon dhe arkivon një procesverbal që mban: Emrin e gazetës,

datat kur janë botuar njoftimet dhe numrin e afisheve sipas vendeve ku janë vendosur.

6. Kushdo që dëshiron të marrë pjesë në ankand, duhet të paraqesë kërkesën me shkrim, si dhe:

a) Një dëftesë që tregon pagesën prej 20% të vlefës së fillimit të ankandit, e cila paguhet në llogarinë e specifikuar më poshtë.

b) Një deklaratë me shkrim për prejardhjen e parave.

c) Listën me firmat e grupeve pjesëmarrëse, që janë dakord të bëhen bashkëpronarë të ndërmarrjes, i deklaruar ky vullnet i tyre para noterit, ku grupet mund të vendosin përfaqësuesit e tyre.

d) Dokumentet zyrtare që provojnë se:

- Kanë ose jo detyrime tatimore dhe doganore ndaj shtetit.

- Kanë ose jo detyrime kredi të marra nga bankat e nivelit të dytë me seli në Republikën e Shqipërisë.

- Kanë ose jo detyrime debitore ndaj ndërmarrjes që privatizohet ose ndaj ndërmarrjeve të tjera.

Në pamundësi për t'i siguruar në kohë këto dokumente, kandidatët të plotësojnë nën përgjegjësinë personale një deklaratë me shkrim.

Mosvërtetësia e deklaratës konsiderohet mashtrim dhe shërben si shkak për pavlefshmërinë e kontratës.

- Kërkesat dhe dokumentet plotësuese do të paraqiten detyrimisht deri brenda afatit të pranimit të kërkesave.

Paraqitja e kërkesave jashtë këtyre afateve është e pavlefshme.

7. Paga bëhet në çdo degë të Bankës Tregtare Kombëtare të Shqipërisë në llogarinë 131/01 të AKP ose degës së AKP.

8. Ish-pronari i truallit, bashkëngjitur kërkesës për blerjen e ndërmarrjes që shtrihet mbi truallin ish-pronë e tij, duhet të paraqesë në degën e AKP, përveç sa kërkohet në pikën 6, edhe vendimin përkatës të Komisionit të Kthimit dhe të Kompensimit të Pronave ish-Pronarëve që vërteton se ai është pronari i truallit. Dega e AKP kërkon vërtetim nga nënkomisioni i privatizimit në pushtetin lokal se trualli i ndërmarrjes përputhet me truallin ish-pronë private, duke përcaktuar se sa zë në përqindje në gjithë truallin e ndërmarrjes, vetëm në rastet kur nuk përcaktohet qartë me vendimin përkatës të Komisionit të Kthimit të Pronave.

E drejta e parablerjes së ish-pronarëve të truallit duhet të ushtrohet në përputhje me udhëzimin e Këshillit të Ministrave nr.13, datë 18.3.1993.

Vendimi i Komisionit të Kthimit të Pronave duhet të dorëzohet në degën e AKP ose AKP detyrimisht deri para zhvillimit të ankandit. Në rast të kundërt ish-pronari i truallit e humbet të drejtën e parablerjes dhe i nënshtrohet ankandit.

Kur sipërfaqja e truallit ish-pronë private është mbi 80% e gjithë truallit nën objektet e ndërmarrjes, e drejta e parablerjes shtrihet mbi gjithë ndërmarrjen.

Në rastet kur ndërmarrjes i është ulur vlefja e fillimit të ankandit (si pasojë e mosprivatizimit me çmimin fillestar të publikuar), ish-pronari, për të gëzuar të drejtën e parablerjes, duhet të bëjë pagesën sipas vlefës fillestare dhe jo sipas vlefës së ulur.

9. I gjithë materiali i përshkruar në pikat 6 dhe 8, në ditën e mbarimit të afatit të pranimit të kërkesave, mbyllet nga dega e AKP dhe mbahet në dispozicion për t'u paraqitur në mbledhjen e bordit të degës AKP ose AKP.

Kryetari i degës AKP, jo më vonë se 5 ditë nga afati i pranimit të kërkesave, u dorëzon zyrtarisht kryetarit të këshillit të rrethit dhe kryetarit të bashkisë lajmërimin për qenien gati të materialit për ankand, duke përcaktuar edhe datën e zhvillimit të mbledhjes. Mbledhja e bordit duhet të zhvillohet detyrimisht jo më vonë se 5 ditë nga koha e lajmërimit.

Bordi i degës së AKP ose AKP, nëpërmjet kontrollit të pjesëmarrjes në privatizim, nuk duhet të lejojë që prona shtetërore t'u kalojë personave fizikë e juridikë, të cilët kanë shkelur afatet dhe detyrimet financiare me shtetin dhe institucionet e tjera financiare (shih pikën 6/d).

Çdo motiv i kësaj natyre do të mbahet në procesverbalin e mbledhjes së bordit dhe do të nënshkruhet me firmë nga të gjithë anëtarët e bordit.

Bordi i degës së AKP ose AKP nuk ka të drejtë të marrë vendim për çështje që nuk kanë të bëjnë me shqyrtimet e mësipërme. Çdo vendim tjetër është i pavlefshëm.

Bordi i AKP ka të drejtë të delegojë shqyrtimin e kandidatëve për në ankand për privatizimin e

ndërmarrjeve nacionale në bordet e degëve përkatëse.

10. Bordi i degës së AKP përbëhet nga këta anëtarë:

1. Kryetari i degës së AKP (drejtues teknik i bordit)
2. Kryetari i këshillit të rrethit
3. Sekretari i këshillit të rrethit
4. Kryetari i bashkisë
5. Kryetari i këshillit bashkiak
6. Sekretari i bashkisë
7. Shefi i financës së bashkisë
8. Shefi i financës së bashkisë të qendrës
9. Shefi i kontrollit të revizionit të bashkisë
10. Shefi i tregtisë së bashkisë
11. Shefi i seksionit të prognozës së politikës ekonomike të bashkisë
12. Drejtuesi i drejtorisë së bujqësisë dhe i ushqimit të rrethit
13. Drejtuesi i drejtorisë së arsimit
14. Drejtori i drejtorisë së shëndetit publik
15. Kryetari i dhomës së zyrës së tatimeve të bashkisë
16. Kryetari i dhomës së tregtisë
17. Drejtori i degës BKT
18. Drejtori i degës së Bankës së Kursimeve
19. Kryetari i SHIK-ut
20. Kryetari i degës së punëve të brendshme
21. Kryetari i zyrës së punës
22. Kryetari i degës së Komitetit të ish-të përndjekurve politikë në rreth

Në raste të veçanta lejohet që anëtarët e bordit të degëve të AKP ose AKP të zëvendësohen nga zëvendësi i tyre.

11. Vendi dhe ora e saktë e fillimit të ankandit shpallet jo më vonë se 2 ditë nga mbledhja e bordit të degës së AKP ose 5 ditë nga mbledhja e bordit të AKP.

Nëse ndryshohet data e zhvillimit të ankandit nga AKP ose dega e AKP, duhet të lajmërohen të gjithë kandidatët pjesëmarrës në ankand për datën e re, e cila vendoset jo më vonë se 5 ditë nga njoftimi.

12. Komisioni i ankandit përbëhet nga këta persona:

- | | |
|---|---------|
| 1. Përfaqësuesi i KPPP | Kryetar |
| 2. Përfaqësuesi i AKP | anëtar |
| 3. Përfaqësuesi i ministrisë që mbulon veprimtarinë | anëtar |
| 4. Përfaqësuesi i ndërmarrjes | anëtar |

Për ankandet e bërë nga degët e AKP në rrethe anëtarë të komisionit të ankandit janë si më poshtë:

- | | |
|---|---------|
| 1. Përfaqësuesi i nënkomisionit të privatizimit në pushtetin lokal | kryetar |
| 2. Përfaqësuesi i degës së AKP | anëtar |
| 3. Përfaqësuesi i seksionit të pushtetit lokal që mbulon veprimtarinë që ushtron ndërmarrja | anëtar |
| 4. Përfaqësuesi i ndërmarrjes | anëtar |
| 5. Një pjesëtar i bordit të degës AKP | anëtar |

Pjesëmarrja e kryetarit dhe anëtarëve të komisionit në datën e caktuar për ankand është e detyrueshme. Në rastet e mospjesëmarrjes së anëtarëve të komisionit të ankandit, ai zhvillohet së paku me kryetarin dhe dy anëtarë të tjerë.

Komisioni i ankandit ka këto detyra:

- Të sigurojë që para nisjes së ankandit të gjithë pjesëmarrësit në ankand të jenë të regjistruar dhe të identifikuar sipas letërnjoftimit ose certifikatës së gjendjes civile, apo me prokurë të veçantë përfaqësimi.

- Të paraqesë anëtarët e komisionit te pjesëmarrësit.

- Të deklarojë vleftën fillestare të ankandit.

- Të drejtojë marrjen e ofertave.

- Të sigurojë që dhënia e ofertave të vazhdojë derisa të ketë oferta të tjera përpara shpalljes së

fituesit.

- Të shpallë personin e fundit që deklaroi vlefshëm më të lartë si fitues i ankandit.

Organizuesit e ankandit janë të detyruar të deklarojnë vlefshëm e ofertës fituese 3 herë, në mënyrë që të lejojnë gjithë pjesëmarrësit që të paraqesin ofertat finale.

- Të sigurojë që raporti i përfundimit të ankandit të firmoset nga fituesi i ankandit.

- Në raportin përfundimtar të ankandit duhet:

- Të tregohen dhe vërtetohen rregullueshmëria e drejtimit të ankandit.

- Të dëshmohet se ofertat janë dhënë në përputhje me kushtet e caktuara.

- Të regjistrohen emrat dhe veçoritë e ofruesve.

- Të regjistrohen parregullsitë ose deklaratat për parregullsitë.

- Të regjistrohet vlefshëm dhe pala fituese.

13. Nëse personi që ka fituar të drejtën e blerjes së ndërmarrjes nuk paguan brenda 60 ditëve vlefshëm e plotë të ndërmarrjes, nga dita e paraqitjes si pronar truall, ose mbledhjes së bordit apo ankandit, procesi i privatizimit rifillon për së pari në një datë brenda 10 ditëve nga data e përfundimit të këtij afati 60-ditor.

Procesi rifillon nga pika 5. Depozita e shumës 20% e vlerës së fillimit të ankandit e personit që fitoi të drejtën e blerjes e nuk bëri pagesën e plotë brenda kushteve të mësipërme, nuk i kthehet.

14. Blerësi ka të drejtë të bëjë pagesën në lekë dhe letra me vlerë të lëshuara për privatizim. 5% e vlerës që do të derdhet duhet të jetë në lekë, e cila mbahet si e ardhur e AKP.

Pagesa që do të bëhet sipas vendimit të Këshillit të Ministrave nr.55, datë 30.1.1995, duhet të jetë e specifikuar qartë në dokumentet që vijnë në AKP nga nënkomisionet përkatëse të privatizimit.

15. Pas realizimit të detyrimeve të mësipërme, nënshkruhet kontrata e shitjes nga:

Pala shitëse (përfaqësuesi i AKP, drejtori ose likuidatori i ndërmarrjes) dhe blerësi privat.

Në rastet kur ndërmarrja nuk ka drejtor ose likuidator në emër të tyre, kontrata nënshkruhet nga drejtuesi që mbulon sektorin përkatës, nga ku varet ndërmarrja në ministri ose pushtet lokal.

Nënshkrimi i kontratës nga përfaqësuesit e shtetit dhe dorëzimi i ndërmarrjes nga likuidatori ose drejtori është i detyrueshëm.

Marrja në dorëzim e ndërmarrjes nga blerësi kryhet sipas vendimit të Këshillit të Ministrave nr.47, datë 7.2.1994.

16. Për të gjitha kategoritë e ndërmarrjeve në vartësi nacionale ose lokale, copëzimi i tyre do të kryhet sipas platformës së hartuar nga dikasteri që mbulon veprimtarinë. Në çdo rast dikasteri duhet të kërkojë miratim nga AKP-ja brenda 15-ditësh. Kërkesa duhet të argumentojë që copëzimi në objekte të veçanta do të krijojë mundësinë e zhvillimit të veprimtarisë teknologjike si bashkësi më vete ekonomike.

17. Shfuqizohen vendimet e Këshillit të Ministrave nr.284, datë 25.6.1992; nr.248, datë 27.5.1993; nr.234, datë 24.5.1994; nr.51, datë 31.1.1995 dhe ato pjesë të akteve nënligjore që bien në kundërshtim me këtë vendim.

Për të gjitha aktet nënligjore që i referohen vendimit të Këshillit të Ministrave nr.248, datë 27.5.1993 dhe vendimit të Këshillit të Ministrave nr.234, datë 25.5.1994, zbatohet ky vendim.

18. Propozimet e Këshillit të Ministrave, nga ana e dikastereve ose institucioneve qendrore dhe pushtetit lokal për nxjerrjen e akteve nënligjore lidhur me procesin e privatizimit bëhet vetëm nëpërmjet bordit drejtues të AKP.

19. Ndërmarrjet, për të cilat procesi i privatizimit ka filluar sipas vendimit të Këshillit të Ministrave nr.234, datë 24.5.1994, të vazhdojnë procedurën sipas atij vendimi.

20. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Agjencia Kombëtare e Privatizimit.

Ky vendim hyn në fuqi në datën 16.5.1995.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi